REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE
TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
DURRËS

NJOFTIM

PËR VEND VAKANT NË POZICIONIN SEKRETAR PRANË PROKURORËVE

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, kërkon të punësojë ***1 (një) punonjës në administratë në pozicionin*** **"**Sekretar pranë Prokurorëve'**"**.

NJOFTON:

1.Fillimin e procedurës së hapur për konkurim të kandidatëve për pozicionin **1 (një) vend "Sekretar pranë Prokurorëve'"** në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

2.Referuar neneve 68,74,75,76, të ligjit nr 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", kandidatët e interesuar për konkurim, përvec kushteve të përgjithshme për t'u pranuar në shërbimin civil, duhet të plotësojnë dhe kritere të veçanta si më poshtë:

Arsimi, trajnimi dhe eksperienca:

1. Kushtet e përgjithshme:

Të jetë shtetas shqiptar;

Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;

Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;

Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje si dhe të mos jetë nën hetim;

Të mos jetë marrë masa disiplinore në marrëdhënie punë dhe/ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e konkurimit;

Të ketë përfunduar ciklin e pare të studimit Bachelor në drejtësi dhe ciklin e dytë të studimeve universitare Master për "Drejtësi";

Të kenë përvoje punë jo me pak se një vit të njohur si praktikë profesionale ose çdo lloj përvoje tjetër profesionale që lidhet me prokurorinë;

Të njohë Ligjin "Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike**";**

Të njohë ligjin "Për Prokurorinë";

Të ketë njohuri të gjuhëve të huaja.

2. Kushtet e posaçme:

Të ketë aftësi për të krijuar marrëdhënie pune efektive me stafin e prokurorisë.

Të ketë aftësi komunikuese dhe pune në grup.

Të ruajë sekretin hetimor.

Të këtë integritet dhe cilësi të larta morale.

Personat e interesuar duhet të paraqesin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, **deri më datën 21.11.2024 ora 16.00, këto dokumenta**:

a) Kërkesë për punësim.
b) Fotokopje e letërnjoftimit/kartës së identitetit/pasaportë;
c) CV (Jetëshkrim) të detajuar ;
d) Diplomë e shkollës së lartë, master, çertifikatë notash dhe çdo diplomë tjetër që tregon specializimin në fushën e caktuar;
e) Dëshmi penaliteti;
f) Vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria që nuk ndiqet penalisht;
g) Fotokopje te librezës së punës ose vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore që të provojë punësimin e mëparshëm ose vërtetim nga qendra e mëparshme e punës, ku të evidentohet pozicioni i punës dhe kohëzgjatja;
h) Vërtetim mjekësor për gjëndjen shëndetësore.

Pranimi i dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët do të bëhet në Zyrën e Protokollit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, **deri më datën 21.11.2024 ora 16.00.**

Konkurimi për vendin e punës në pozicionin " Sekretar pranë Prokurorëve'" do të zhvillohet në dy faza :

Faza e parë: verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga kandidatet, e cila realizohet nga Kryesekretari i kësaj Prokurorie me qëllim vlerësimin e dokumentacionit nëse janë plotësuar kriteret e shpallura në njoftim.

Kandidatët të cilët nuk arrijnë të plotësojnë kërkesat e përcaktuara skualifikohen.

Faza e dytë: Testimi (me shkrim, me gojë).

Kandidatët e kualifikuar i nënshtrohen intervistës së strukturuar me gojë, vlerësimit me shkrim si dhe vlerësimit të jetëshkrimit ku konsiston arsimimi, përvoja e punës, kualifikimet, trajnimet aftësite profesionale.

Totali i pikëve të vlerësimit është 100 pikë të mundshme të cilat ndahen në këtë kategorizim:

Vlerësimi i jetëshkrimit, eksperienca e trajnimeve etj, 20 pikë
Vleresimi i testimit me shkrim, 50 pikë
Vlerësimi për intervisten e strukturuar me gojë, 30 pikë

Testimi do të bazohet në kërkesat mbi kriteret e veçanta dhe njohuritë mbi fushën e specifikuara.

Që kandidatët të shpallen fitues duhet të marrin mbi 70 pikë.

Vlerësimi i kandidatëve nga komisioni do të bëhet bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga secili kandidat si dhe rezultati i testimit me shkrim dhe të intervistës me gojë me secilin prej tyre.

- Intervista e strukturuar me gojë do të zhvillohet në datë 26.11.2024 ora 10.00-12.00, në ambientet e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

-Testimi me shkrim do të zhvillohet në datë 26.11.2024, ora 12:00 -14.00, në ambientet e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë te Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

KOMISIONI I PRANIMIT PËR PROCEDURAT E PUNËSIMIT NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DURRËS